



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 2547/21; Datë:10.09.2021

Në bazë të nenit 46 dhe nenit 48 paragrafi 1.16 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur më 10. 09.2021, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për punën e Senatit të UShAF.

II.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.



A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të harmonizimit të rregulloreve me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



Në bazë të nenit 46 dhe nenit 48, paragrafi 1.16 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF, në mbledhjen e mbajtur më 10.09.2021, miraton:

Rregullore për punën e Senatit

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Senatit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti) si: thirrja e mbledhjes, kryesimi, mbajtja, mënyra e vendosjes, procedura e zgjedhjes, dhe zbatimi i vendimeve dhe çështje të tjera përkatëse.

II. Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Senatit

Neni 2

- (1) Mbledhjen konstituive të Senatit e thërret Rektori aktual i Universitetit, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjidhet kryesuesi i përkohshëm i Senatit.

Neni 3

- (1) Në mbledhjen e parë, Senati i verifikon mandatet e anëtarëve të Senatit në bazë të raportit të Sekretarit të përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve në Senat nga njësitë akademike, me propozim për verifikimin e mandatit.
- (2) Votimi për raportin bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat është kontestuar, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj për çdo mandat të kontestueshëm votohet veç e veç.
- (3) Nëse Senati konstaton se zgjedhja është bërë në mënyrë jo të rregullt, Senati do të kërkojë nga njësitë akademike që zgjedhjet e kontestuara të përsëriten.
- (4) Anëtari i Senatit, të cilit i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhje, por pa të drejtë vote.

Neni 4

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Senatit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon: "Deklaroj se do t'i kryej detyrat me nder dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t'i përmbahem Statutit të Universitetit.

III. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Senatit

Neni 5

- (1) Kryesuesi i përkohshëm i Senatit zgjedhet nga kandidatët e propozuar në Senat me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (2) Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Senati është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.
- (3) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

IV. Mbledhjet

Neni 6

- (1) Mbledhjet e Senatit i thërret dhe i kryeson Rektori i Universitetit (në tekstin e mëtejshëm: kryesuesi).
- (2) Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson Zëvendësrektori. Nëse mungon Zëvendësrektori mbledhjen e kryeson njëri prej prorektorëve sipas radhës së paraparë nga rektori. Nëse edhe prorektorët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Senatit e kryeson anëtari më i vjetër i Senatit.
- (3) Kryesuesi mbledhjet i thërret sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Senatit mbahen sipas kërkesave dhe nevojës.
- (4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore. Në mbledhjen e Senatit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhshme të Senatit. Në këto raste anëtarët e Senatit që nuk janë të pranishëm, duhet të ftohen posaçërisht.
- (5) Në rast të shkarkimit të Rektorit dhe prorektorëve, procedurën e zgjedhjes e organizon anëtari më i vjetër i Senatit, pa asnjë vonesë.
- (6) Mbledhjet e Senatit janë të mbyllura për publikun, pos në rastet kur Senati vendos ndryshe.



- (7) Anëtarët e Senatit ftohen së paku 48 orë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me e-mail, ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
- (8) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspertë ose persona të tjerë në mbledhje.
- (9) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Senatit nëse këtë e kërkojnë shumica e anëtarëve të Senatit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Senatit nuk i përgjigjet kërkesës brenda tri ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, mbledhjen e Senatit e thërret anëtari më i vjetër i Senatit.

V. Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

Neni 7

- (1) Të gjithë anëtarët e Senatit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Senatit.
- (2) Gjatë mbledhjeve të Senatit, anëtarët duhet të votojnë personalisht. Delegimi i votës nuk lejohet.
- (3) Para se të fillojë mbledhja e Senatit, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Senatit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Senatit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.

Neni 8

- (1) Për një anëtar të Senatit konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me rregullativën juridike dhe Statutin e Universitetit, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.
- (2) Anëtari në konflikt interesi duhet të lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur diskutohet ajo çështje.

VI. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

Neni 9

- (1) Kryesuesi e hap, kryeson, ndërpret dhe përfundon mbledhjen.
- (2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Senatit kujdeset kryesuesi në koordinim me prorektorët dhe sekretarin e përgjithshëm me shërbimet përkatëse.
- (3) Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës t'i përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim, të dërguara 48 orë para mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, me e-mail dhe të nënshkruara nga parashtuesi.



- (4) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
- (5) Kryesuesi i jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform me këtë Rregullore.
- (6) Anëtarët e Senatit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
- (7) Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes mund të miratohen me shumicën absolute të votave.

VII. Ecuria e mbledhjes

Neni 10

- (1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- (2) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- (3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Senatit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet, lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
- (4) Kryesuesi jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e Senatit askush nuk mund të diskutojë pa e marr fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- (5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas radhës.
- (6) Për çdo pikë të rendit të ditës, pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë, herën e parë deri pesë minuta, të dytën deri dy minuta.
- (7) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës.
- (8) Pjesëmarrësi, i cili e merr fjalën, është i obliguar t'i përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundojë diskutimin pjesëmarrësi, ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohet pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit, mund të zgjasë më së shumti dy minuta.
- (9) Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Senatit kjo mund të zgjatet.



Neni 11

Senati, në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Senatit, mund të vendos që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Neni 12 - Kërkesat dhe ankesat

- (1) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të parashtojë kërkesë - ankesë për temën e caktuar.
- (2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa - ankesa të parashtrahet me shkrim.
- (3) Kërkesat - ankesat për rregullat procedurale duhet të arsyetohen shkurtimisht. Me kërkesë një folës "për" dhe një folës "kundër", mund ta marrin fjalën.

Kërkesat - ankesat për rregullat e procedurës mund të parashtrahen për dy arsye:

- a) kërkesa për mbylljen e listës së folësve të regjistruar, nëse kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë, vetëm folësit e regjistruar në listë gjatë parashtrësës së kërkesës do të kenë të drejtë ta marrin fjalën.
- b) Kërkesa për përfundimin e shqyrtimit, nëse kërkesa miratohet me shumicë të kualifikuar të 2/3 të anëtarëve, diskutimi mbaron dhe kërkesat tjera votohen.

VIII. Vendosja - votimi dhe zgjedhjet

Neni 13

- (1) Senati i Universitetit vendos plotëfuqishëm vetëm kur në mbledhje janë prezent së paku shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- (3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Senati merr vendim ose konkluzion.
- (4) Vendimet, Senati i merr me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga organet e Universitetit, pastaj për propozimet tjera.
- (6) Votimi bëhet i hapur ose me vota të fshehta. Se si do të bëhet votimi, Senati vendos në mbledhjen përkatëse.
- (7) Votimi bëhet: "për", "kundër" dhe "abstenim".
- (8) Në rast të numrit të votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Neni 14

- (1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Senati i përbërë prej tre anëtarëve.



- (2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose i konkluzionit është miratuar ose është refuzuar.

Neni 15

- (1) Votimi me vota të fshehta bëhet për:
- Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
 - Për zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Senatit;
 - Çështjet që kanë lidhje me intimitetin e ndonjërit nga anëtarët e Senatit;
 - Çështjet kur kryesuesi kërkon për votim të fshehtë.
- (2) Numërimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikëqyrjen e Sekretarit të përgjithshëm.

IX. Komisioni profesional për propozimin e listës për Rektor

Neni 16

- Përcaktimi i listës së kandidatëve për pozitën e Rektorit bëhet nga Komisioni Profesional i zgjedhur nga Senati.
- Komisioni përbëhet prej anëtarëve të Senatit dhe atë më së shumti deri në 5 anëtarë.
- Komisioni ka për detyrë të konstatojë nëse kandidatët e paraqitur për Rektor i plotësojnë kushtet e parapara me konkursin për Rektor të shpallur nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni profesional propozon listën e kandidatëve të zgjedhur, me shumicë votash, për t'u zgjedhur nga Këshilli Drejtues.

X. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni 17

- Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të bëjë propozime për kandidatët për anëtarë të Këshillit Drejtues të Universitetit.
- Propozimet për kandidatë duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtër për kandidatin.
- Zgjedhja e kandidatëve bëhet me dy votime të njëpasnjëshme.
- Nominimi i kandidatëve për Këshill Drejtues në radhën e parë të votimit bëhet me shumicën relative, me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç.



Vetëm kandidatët që arrijnë shumicën relative do të kalojnë në radhën e dytë të votimeve.

- (5) Në radhën e dytë, votimi do të bëhet për të gjithë kandidatët që kualifikohen në radhën e parë. Zgjedhja duhet të bëhet me vota të fshehta me fletëvotime sipas alfabetit. Secili anëtar i Senatit duhet të rrumbullakësojë deri në katër kandidatë në fletëvotim. Fletëvotimet me më shumë se 4 kandidatë konsiderohen të pavlefshme. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk arrihet që të plotësohet lista prej katër kandidatëve të zgjedhur me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve bëhet edhe votimi i katërt. Lista e anëtarëve të Këshillit Drejtues plotësohet me kandidatë që kanë marrë më së shumti vota në radhën e katërt të votimit.
- (6) Në rast të numrit të barabartë të votave, një votim vendimtar do të bëhet për anëtarët me numër të barabartë votash. Kandidatët me shumicë relative votash, sipas rregullave të parapara më lartë, do të zgjidhen si anëtarë të Këshillit Drejtues.

XI. Zgjedhja e dekanëve dhe e prodekanëve

Neni 18

- (1) Vendimet propozuese mbi zgjedhjen e dekanëve të fakulteteve miratohen nga Senati i Universitetit.
- (2) Miratimi i propozimit bëhet në mbledhjen konstituive të Senatit, pas verifikimit të mandateve të anëtarëve të Senatit dhe pas zgjedhjes të kryesuesit të përkohshëm të Senatit.
- (3) Miratimi i propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor të Universitetit për zgjedhjen e dekanëve bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Senatit me votim të hapur, për secilin veç e veç.
- (4) Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.
- (5) Miratimi i propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor për zgjedhjen e prodekanëve bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Senatit me votim të hapur, për secilin veç e veç.
- (6) Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.

XII. Mbajtja e rendit në mbledhje

Neni 19

- (1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.



- (2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Senatit janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregullore.
- (3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - Vërejtje,
 - Marrja e fjalës dhe
 - Largimi nga mbledhja.

Neni 20

- (1) Vërejtje me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
- (2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Senatit, që me sjelljet dhe me deklaratat e tij çrregullon punën normale të Senatit për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- (3) Vërejtjen dhe marrjen e fjalës i shqipton kryesuesi.
- (4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse, edhe pasi t'i merret fjala, pengon mirëvajtjen e mbledhjes.
- (5) Largimin nga mbledhja e shqipton Senati me shumicë votash. Pjesëmarrësit, të cilët i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

Neni 21

Procesverbali nga mbledhja e Senatit

- (1) Në çdo mbledhje të Senatit mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
- (2) Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - a) vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes,
 - b) rendin e ditës,
 - c) listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë,
 - d) të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse,
 - e) shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.

Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.

- (3) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave, pas mbledhjes së Senatit dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të Senatit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Senatit.
- (4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës të Senatit.
- (5) Procesverbali ruhet në arkiv të Universitetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës, si dokumente afatgjata.

XIII. Puna e komisioneve

Neni 22

- (1) Komisionet janë organe ndihmëse të Senatit.
- (2) Komisionet e formuara nga Senati në pajtim me Statutin e Universitetit i ndihmojnë Senatit për çështje të veçanta të punës së tij.

XIV. Aktet e Senatit

Neni 23

- (1) Senati nxjerr:
- Rregullore,
 - Vendime,
 - Konkluzione,
 - Rekomandime.
- (2) Senati jep interpretim autentik të akteve që i miraton.
- (3) Procesmbajtësi është i obliguar të përgatisë vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet nga mbledhja e Senatit, ndërsa rregulloret i përgatit komisioni përkatës.

Neni 24

Dispozitat e kësaj Rregullore vlejnë për të gjithë anëtarët e Senatit dhe për persona tjerë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Senatit.

Neni 25

Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këte Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe të Ligjit mbi Arsimin e Lartë.

XV. Dispozitat përfundimtare

Neni 26

- (1) Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregullore kujdeset kryesuesi i Senatit.
- (2) Interpretimin autentik të kësaj Rregullore e jep Senati.
- (3) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati i Universitetit.

Neni 27

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore mund të bëhen sipas së njëjtës procedurë të miratimit.

Neni 28

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja e punës së Senatit të UShAF nr, 152/2016 e datës 02.02.2016

Kryesues i Senatit të UShAF
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI, Rektor

